



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05/666

Dt. 04/11/2020

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit shpallë:

### Konkurs për plotësimin e vendeve të punës

**Pozita:** Punëtor teknik - pastrues

**Vendet e punës:** Në shkollat e Komunës së Podujevës si në vijim:

- Gjinnazi "Aleksandër Xhuvani" Podujevë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Dr.Ibrahim Rugova" Podujevë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Luigj Gurakuqi" Batllavë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Emin Duraku" Bajçinë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Dituria" Llapashticë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Elfir Behrami" Metehi (një punëtor/e teknike/)
- Shfmu "Shefki Kuleta" Tërrnavë (një punëtor/e teknik/e)
- Shmle "Isa Boletini" Podujevë (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Nuhi Gashi" Bradash (një punëtor/e teknik/e)
- Shfmu "Eqrem Çabej" Buricë (një punëtor /e teknik/e)

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit (me mundësi vazhdimi)

### Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lendeve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;.
- Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

### Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

### Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve).

## II. Pozita: Roje nate

Vendet e punës: Në shkollat e Komunës së Podujevës si në vijim

- IP “ Armela” Podujevë ( një roje nate)
- Shfmu “ Xheladin Rekaliu” Podujevë ( një roje nate )

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit ( me mundësi vazhdimi)

### Detyrat kryesore të punës:

- Regjistrohet në ditarin e punës;
- Përkujdeset për sigurinë e ndërtesës së shkollës, përfshirë edhe oborrin;
- Mbikëqyrë hyrjet dhe daljet në objekt;
- Bën kontrollimin e objektit dhe rreth tij;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtori i shkollës;

### Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

### Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranojnë pas publikimit të rezultateve).

### Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 dite kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 19.11.2020.



Drejtori i DKA-së  
Agim Blakçori